

RIDOMIL GOLD R WG

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE



“Lexo fletudhëzuesin para përdorimit”

Fungicid sistemi dhe kontakti për kontrollin e vrugjeve.

Lënda vepruese: 2% metalaxyl-M+14,19% oksiklorur bakri.

Formulimi: Granula të dispergueshme në ujë (WG).

Masat parambrojtëse:

- P102: Mbajeni larg aritjes prej fëmijëve.
- P201: Merrni instruksion të veçante para përdorimit.
- P202: Mos filloni punën pa lexuar dhe kuptuar mirë masat e perkujdesit.
- P261: Shmangni frymëmarrjen mbi pluhurin.
- P270: Mos hani, pini, tymosni duhan, kur jeni duke punuar me këtë produkt.
- P272: Veshjet e punës të ndotura me produktin nuk lejohet të vendosen jashtë vendit të punës.
- P280: Vishni paisje mbrojtëse si doreza, mbrojtëse për sytë dhe për fytyrën.
- P281: Përdorni paisje mbrojtëse personale sipas kërkesave.
- EUH401: Për te shmangur risqet ndaj shëndetit njerëzor dhe mjedisit, zbatoni udhëzimet për përdorimin.
- P501: Hidheni përmbajtjen/kontejnerin në...

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- Në rast kontakti me lëkurën: Hiqni të gjitha rrobat e ndotura menjëherë. Lahuni mirë me ujë të bollshëm dhe sapun. Nëse acarimi vazhdon telefononi një mjek
- H318: Shkakton dëmtim të rëndë syri. Në rast kontakti me sytë i lani menjëherë me ujë të bollshëm për disa minuta dhe kërkon ndihmë mjekësore.
- H332: E dëmshme nëse thithet. Në rast se merret me organet e frymëmarrjes, nxireni të aksidentuarin në ajër të pastër. Mbajeni të ngrohtë dhe të çlodhur. Nëse nuk merr frymë i bëni frymëmarrje artificiale. Thërisni mjekun menjëherë.
- H302: E dëmshme nëse gjëllitet. Në rast gjëllitje kërkon menjëherë këshilla mjekësore dhe tregoni etiketën. Mos provokoni të vjella.
- Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi simptomatik.

Përdorimi:

Përdoret me spërkatje gjethore në trajtimet parambrojtëse për luftimin e vrugjeve në:

Kulturat bujësore	Sëmundjet	Doza			Koha e trajtimit	Nr maksimal i trajtimeve/sezon
		gr/100 lit ujë	sasia tretës spërk (lit/dyn)	maksim (gr/dyn)		
Hardhi	<i>Plasmopara viticola</i>	500	100	500	Nga dalja e gjethit të 9 ^{te} deri në fillim të pjekjes	2-4 trajtime me interval 10-14 ditë.
Domate	<i>Phytophthora infestans</i>				Nga dalja e gjethit të 5 ^{te} deri në pjekje	3-4 trajtime me interval 10-14 ditë.
Patate	<i>Phytophthora infestans</i>				Nga dalja e gjethit të 1 ^{te} deri në vjelje	2-3 trajtime me interval 10-14 ditë.
Qepë	<i>Peronospora destructor</i>				Nga dalja e gjethit të 1 ^{te} deri në vjelje	
Sallatë, bimë aromatik	<i>Peronospora spp</i> <i>Bremia spp</i>				Nga dalja e gjethit të 1 ^{te} deri në vjelje	
Brokol, lulelakër	<i>Alternaria brassicae</i> <i>Peronospora parasitica</i> <i>Bremia spp</i>				Nga dalja e gjethit të 1 ^{te} deri në vjelje	

Shalqi, pjepër	<i>Peronospora cubensis</i>				Nga dalja e gjethit të 6 ^{te} deri në pjekje	
----------------	-----------------------------	--	--	--	---	--

Mënyra e përgatitjes së tretësirës spërkatëse: Mbushni me ujë deri në mes pompën spërkatëse dhe filloni përzjerjen. Hidhni dozën e duhur të preparatit duke vazhduar përzjerjen dhe plotësoni pompën me sasinë tjetër të ujit.

Vërejtje per perdorimin:

Përzihet me shumicën e fungicideve dhe insekticideve me reaksion neutral që përdoren në këto kultura. Filloni spërkatjet kur paraqiten kushte të favorshme për sëmundjen. Në kushte veçanërisht të favorshme për patogjenin, zvogëloni intervalin ndërmjet spërkatjes së fundit me Ridomil Gold R WG dhe produktit tjetër, duke vazhduar mbrojtjen e bimëve me fungicide me mekanizëm të ndryshëm veprimi. Prania e bakrit zgjeron spektrin e veprimit të produktit edhe ndaj sëmundjeve bakteriale. Përdorni sasinë e duhur të ujit për mbulimin e plotë dhe uniform të kulturave bujqësore të spërkatura, duke shmangur pikimin nga gjethet. Nëse konstatohet mosefektivitet i trajtimëve për shkak të shfaqjes së shtameve rezistente ndaj phenylamideve, ndaloni përdorimin e produktit dhe zëvendësojeni atë me fungicide kontakti. Të mos përdoret në fidanishtet e hardhisë. Të mos përdoret në periudhën e lulëzimit në varietet e hardhisë që kanë ndjeshmëri ndaj bakrit.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur përdoret në kulturat dhe dozat e rekomanduara.

Ndikimi ne mjedis:

H410: Shumë toksike për jetën ujore me efekte afatgjata. Mos ndot burimet ujore që përdoren për ujë, për qellime shtëpiake, etj, me mbeturinat e ambalazheve ose solucionin spërkatës. Për të mbrojtur organizmat ujorë, mos e përdorni në një distancë më të afert se 5 m nga sipërfaqet ujore.

P273: Shmangni shkarkimet në mjedis.

P391: Mblidheni atë që derdhet.

Karenca:

Hardhi, brokol, lule lakër 20 ditë; Domate, qepë, shalqi dhe pjepër 3 ditë; Patate, sallatë, bimë aromatike 14 ditë.

Ruajtja dhe magazinimi:

Preparati ruhet në kuti të mbyllura, në vende të thata e të ftohta, në temperaturë deri 35⁰ C. Preparati të mos mbahet në diell e në lagështi.

Nr dhe data e regjistrimit: 689/2, datë 4.12.2020;

Sasia neto e PMB-së apo lëndës vepruese, që ndodhet në ambalazhin bazë: deri 1 kg;

Data e prodhimit: _____;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesëve të përcaktuara): 3 vjet;

Numri i serisë ose shenja të tjera identifikuese: _____;

Tipi i ambalazhit baze: Material 3-shtresor për mbrojtjen nga lagështia;

Emri dhe adresa e aplikantit: Syngenta Crop Protection AG. **Adresa:** Bazel, Switzerland;

Emri dhe adresa e prodhuesit: Syngenta Crop Protection AG. **Adresa:** Bazel, Switzerland.